UDHËZIM
Nr. 11, datë 24.7.2023

PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 10, DATË 26.1.2015, "PËR RREGULLAT DHE PROCEDURAT E SHQYRTIMIT TË ANKIMEVE ADMINISTRATIVE TË SUBJEKTEVE MINERARE TË LICENCUARA"

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, si dhe të pikës 5, të nenit 45, pikës 5, të nenit 46, të ligjit nr. 10 304, datë 15.7.2010, "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar

UDHËZOJ:

1. Në udhëzimin nr. 10, datë 26.1.2015, bëhet ndryshimi si më poshtë:
a) Pika 6, ndryshon me përmbajtje si më poshtë:
"6. Njësia e vlerësimit të ankimeve përbëhet nga 7 anëtarë, me përbërje si më poshtë:
i. Sekretari i Përgjithshëm ose një nga drejtorët e përgjithshëm të aparatit të ministrisë, kryetar;
ii. dy përfaqësues nga drejtoria përgjegjëse për fushën e minierave, anëtar;
iii. një përfaqësues nga drejtoria përgjegjëse për çështjet juridike, anëtar;
iv. një përfaqësues nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, anëtar;
v. një përfaqësues nga Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera, anëtar;
vi. një përfaqësues nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, anëtar.".
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi institucionet e përmendura në pikën 6 dhe Njësia e Vlerësimit të Ankimeve të Masave Administrative.
Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
DHE MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Belinda Balluku